



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.02.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Klodiana Spahiu – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 4, 5 dhe 11 shkurt 2019.
2. Shqyrtimi në parim i projektligjit "Për nxitjen e punësimit". *(Komisioni përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Edlira Bode, Adelina Rista, Nuri Belba, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Blerina Gjylameti, Klotilda Bushka, Vilma Bello.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Bardh Spahia, Grida Shqina Duma, Orjola Pampuri, Lindita Metaliaj, Halim Kosova, Floida Kërpaçi dhe Vangjel Tavo.

Të ftuar:

Anila Denaj – Ministre e Ekonomisë dhe Financave

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Klodiana Spahiu – Përshëndetje të gjithëve!

Sot Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë zhvillon mbledhjen e radhës, sipas kalendarit të përcaktuar.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 4, 5 dhe 11 shkurt.

Kush është pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Pika e dytë e kalendarit është shqyrtimi në parim i projektligjit “Për nxitjen e punësimit”.

Është nismë e Kryeministrit. Ne jemi komision përgjegjës për shqyrtimin e këtij projektligji, i cili tashmë ka ardhur si një projektligj i ri.

Të ftuar janë ministrja e Ekonomisë dhe Financave, zonja Anila Denaj dhe zëvendësministrja, zonja Dajna Sorensen.

Urdhëroni, zonja Ministre, për të bërë paraqitjen e projektligjit!

Anila Denaj - E nderuar nënkryetare,

Të nderuar deputetë,

Projektligji “Për nxitjen e punësimit”, u hartua me qëllim reflektimin e ndryshimeve dhe dinamikave të tregut të punës, pas një periudhe 23- vjeçare, që nga viti i miratimit të ligjit ekzistues (1995). Gjithashtu, projektligji u hartua nën frymën e vizionit qeverisës, ku kualifikimi profesional dhe punësimi duhet të jenë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Nevoja për rishikimin e politikave aktuale për nxitjen e punësimit dhe ato të sistemit të kualifikimeve, në kuadër të përfshirjes së Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP-së), ishte e domosdoshme.

Programi i qeverisë 2017- 2021 e ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës, në përputhje me vizionin dhe direktivat e Bashkimit Europian, Strategjinë Europiane të Punësimit 2020, si dhe kërkesat për integrimin europian të Shqipërisë në BE. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020 e ngarkon sistemin me detyra dhe aktivitete në lidhje me qeverisjen e tregut të punës, programe aktive të tregut të punës, të arsimit dhe formimit profesional etj.

Ky projektligj ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit dhe vetëpunësimit, si dhe formimit profesional. Ky ligj përcakton objektivat dhe funksionet e sistemit publik të shërbimeve të

punësimi, programeve aktive dhe pasive të tregut të punës, formimit profesional, si dhe institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e tyre.

Konkretisht, projektligji parashikon një gamë më të gjerë programesh të nxitjes së punësimi se ato të parashikuara në ligjin ekzistues, me një fokus të veçantë tek të rinjtë dhe grupe të tjera vulnerabël në skajet e tregut të punës. Programet e nxitjes së punësimi përfshijnë punët publike, vetëpunësimin, praktikat profesionale apo trajnimin, për të cilat parashikohet subvencionim, në përqindje të caktuar, i kostove për: sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore; pagat; formimin profesional; formimin nëpërmjet punës; vetëpunësimin; mbështetjen për bizneset e reja dhe inkubatorët e biznesit; pajisjen e vendit të punës dhe përshtatjen e arsyeshme; zbatimin e programeve për mbështetjen e kualifikimit profesional në formën e dyfishtë të AFP-së; punësimin e të diplomuarve/certifikuarve në arsimin e formimin profesional; praktikat profesionale; programin e garancisë rinore; programet e riintegritit social; transport për në vendin e punës e të tjera.

Gjithashtu, në projektligj janë parashikuar forma të tjera mbështetjeje, si për ofruesit publikë, ashtu dhe për ata privatë, për t'u mbështetur financiarisht për kryerjen e kurseve për punëkërkuesit e papunë, për profesione të kërkuara në tregun e punës, sipas kërkesave të përcjella pranë zyrave të punësimi.

Në këtë projektligj është parashikuar krijimi i institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësimin (sot Shërbimi Kombëtar i Punësimi), si një njësi, e cila do të mbledhë në një dhe do të rikonceptojë, sipas praktikave më të mira, modernizimin e zyrave të punës, sistemin e shërbimeve të punësimi, programet e nxitjes së punësimi dhe ofertën e përmirësimit të aftësive gjatë gjithë ciklit të jetës.

Në projektligj, janë rregulluar dispozitat në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuar, që nuk kanë gjetur zbatim në ligjin ekzistues. Përveç mbështetjes me programe nxitjeje punësimi, përshtatje të arsyeshme, janë rregulluar dhe çështjet e detyrimit për të punësuar persona me aftësi të kufizuar nga punëdhënësit.

Në projektligj është parashikuar krijimi i Fondit Social të Punësimi, në formën e një fondi financiar publik që administrohet nga Bordi i Administrimit të Fondit. Burimi i financimit të fondit do të jetë kontributi i punëdhënësve, të cilët nuk punësojnë 1 person me aftësi të kufizuar për çdo 49 punonjës të punësuar të tyre dhe në këtë rast janë të detyruar të derdhin një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimi, në masën e 50% të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, për çdo person me aftësi të kufizuar, që ai duhet të kishte punësuar.

Të ardhurat e mbledhura do të përdoren për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësimin dhe riaftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbimet mbështetëse, si dhe përshtatjen e arsyeshme në vende pune të këtyre personave.

Në këtë projektligj është rikonceptuar i gjithë procesi i marrëdhënies me punëdhënësit. Në nenin 19 janë përcaktuar të drejtat e punëdhënësve, duke e konsideruar marrëdhënien me biznesin si një proces bashkëpunimi dhe jo një proces detyrimesh të njëanshme nga ana e punëdhënësve, siç ishte në ligjin e mëparshëm. E gjithë kjo pjesë është riparë dhe në zbatim të paketës Doing Business të miratuar nga Këshilli i Ministrave, me qëllim lehtësimin e procedurave për fillimin e një biznesi të ri. Kështu, në këto nene është parashikuar se çdo punëdhënës ka të drejtë të marrë informacion mbi tregun e punës, legjislacionin e punës, programet shtetërore të punësimit në zyrat e punësimit. Gjithashtu, punëdhënësi ka të drejtë të publikojë në këtë strukturë vendet e lira të punës për të përfituar nga shërbimet e ndërmjetësimit, si dhe të aplikojë.

Projektligji “Për nxitjen e punësimit” u përzgjedh nga Kryeministria për t’u miratuar sipas metodologjisë së re, sipas urdhrit nr.102 të Kryeministrit, datë 14.6.2017 “Për ngritjen e grupeve të punës për pilotimin e zbatimit të metodologjisë së vlerësimit të ndikimit në disa ministri”. Metodologjia e re u hartua dhe iu bashkëlidh paketës së projektligjit në momentin e miratimit nga KM-ja.

Drafti i projektligjit është konsultuar me ekspertë të fushës, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve, OJF të ndryshme, si: Organizata Ndërkombëtare e Punës, ILO, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, UNDP, GIZ, etj., që mbulojnë çështje të PAK-ut, si dhe me të gjithë aktorët e interesit. Gjithashtu, projektligji është miratuar dy herë nga Këshilli Kombëtar i Punës, një herë në 2015 dhe sërish në mbledhjen e fundit të 2018-ës.

Ju falënderoj për vëmendjen! Mbetemi në dispozicionin tuaj, së bashku me zëvendësministren, për t’iu përgjigjur pyetjeve, shqetësimeve apo sugjerimeve që mund të keni.

Klodiana Spahiu - Faleminderit, zonja Ministre!

Në fakt, ne e kemi marrë një ndryshim vetëm në një nga nenet fillimisht para 2-3 muajve, megjithatë me dakordësinë edhe të ministrisë, projektligji do të vinte i ri, siç ka ardhur, dhe këtu janë një sërë ndryshimesh shumë pozitive që kanë të bëjnë me një përfshirje më të madhe të grupeve të interesit dhe sidomos të grupeve të marginalizuara.

Pa humbur kohë, meqenëse sot është edhe dita e mbledhjes së qeverisë, po hapim seancën e pyetjeve.

Të nderuar kolegë, kush ka pyetje?

Urdhëroni, Klotilda!

Klotilda Bushka - Faleminderit!

Faleminderit, zonja Ministre për këtë sqarim shterues!

Më vjen mirë që vini me një draft për një ligj të ri, sepse që nga viti 1995 jemi me të njëjtin ligj që rregullonte këtë fushë.

Në fakt, edhe dinamika e shoqërisë ka ndryshuar dhe në këto kushte është parë e nevojshme edhe në kuadër të strategjisë së qeverisë sa i takon nxitjes së punësimit.

Është tashmë i domosdoshëm krijimi i mekanizmave ligjorë për t'i konkretizuar të gjitha mënyrat se si të arrijmë objektivat që të kemi sa më shumë mundësi për punësim dhe të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë që jep tregu i punës në mënyrë që askush të mos mbetet prapa, duke plotësuar kështu dhe një prej objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

Pyetja ime ka të bëjë me një çështje që është disi teknike sa i takon institucioneve që do të ofrojnë shërbimet sipas ligjit.

Ky ligj, më lejoni t'ju përgëzoj, është një ligj i shkruar shumë mirë dhe që në këndvështrimin tim i ka përmbledhur të gjitha çështjet që janë ngritur dhe janë adresuar me mekanizma zgjidhës. Ju parashikoni që do të krijohet një institucion përgjegjës për zbatimin ligjit dhe për ofrimin e shërbimeve. Deri në ngritjen e këtij institucioni, i cili do të ngrihet në bazë të parashikimeve të një VKM-je, sipas nenit 14 të ligjit të gjitha shërbimet dhe të gjitha kompetencat do t'i ketë Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Si është menduar, sepse nuk shoh në ligj në dispozitat kalimtare, çfarë ndodh me shërbimin real sot, Shërbimin Kombëtar të Punësimit, kur të ngrihet institucioni i ri? A do të shkojë sipas kuadrit ligjor për ristrukturimin e institucioneve që shkrihen/ mbyllen apo do të jetë një vazhdim logjik, por në një kuadër të ri ligjor i institucionit të mëparshëm? Pse e bëj këtë pyetje? E bëj këtë pyetje, sepse gjithmonë kemi shqetësimin e memories institucionale dhe them “memorie institucionale” e kam fjalën tek aftësitë e krijuara të nëpunësve të administratës që mund të kenë vjetërsi në këto detyra dhe në kuadër të ristrukturimit ndodh shpesh që kuadrot të ikin dhe të vijnë të rinjtë, të rinjtë jo se janë më të mirë sesa të vjetrit, nuk e bëj këtë paragjykim, por e kam me merak kujdesin ata që vërtet kanë një vjetërsi, rekord merite profesionale, të merret në konsideratë dhe të jenë pjesë e vazhdimësisë së këtij shërbimi, sepse tek e fundit pavarësisht reformave që na japim shërbime më të mira dhe sipas

standardeve, është shumë e rëndësishme të ruajmë qëndrueshmërinë e atij stafi të administratës publike, për të cilin ka investuar. Ky është i vetmi shqetësim që kam, sepse shikoj që i keni referuar shumë mirë edhe rastet e grupeve në nevojë që është target i këtij komisioni, për sa i përket prioritetit, facilitetit dhe mundësive për punësim.

Faleminderit!

Anila Denaj - Shumë faleminderit!

Në fakt, duke qenë se do të marrë funksione shtesë, kuptohet që është proces strukturimi, por në perspektivë, në eksperiencën aktuale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Unë sapo vij nga një vizitë në një nga zyrat tona në Tiranë dhe jam shumë e kënaqur me rezultatet e arritura. Vitin e kaluar ishin rreth 34 mijë e 669 vende të plotësuara nga Shërbimi në të gjithë Shqipërinë. Ne synojmë që këtë vit të realizojmë 10 mijë vende të tjera vetëm në rajonin e Tiranës. Pra, detyrimisht kjo është një punë e realizuar mirë dhe gjithë kjo eksperiencë me këtë strukturë do të jetë e mbartur në strukturat pasardhëse. Nga ana juridike do të quhet ristrukturim, por nuk do të cenonjmë cilësinë, përkundrazi do të synojmë ta përmirësojmë atë më shumë.

Dajna Sorensen - Do të doja të shtoja një element të fundit, në bashkëpunim me PNUD-in, ne jemi duke ndërmarrë edhe një analizë funksionale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Ajo do të dalë edhe me një strukturë optimale të dakordësuar vetëm për pjesën se çfarë funksione shtesë do të marrë Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Konkretisht ka të bëjë me menaxhimin e ofruesve të arsimit dhe formimit profesional në të tria format e tyre, qofshin qendrat e formimit profesional, shkollat e arsimit profesional apo qendrat multifunktionale që kombinojnë të nxënurit afatgjatë dhe kurset afatshkurtra në një institucion të vetëm. Janë thjesht një shtim i funksioneve për sa i përket ofertës së arsimit dhe formimit profesional. Diskutimi primar në lidhje me to është niveli i decentralizimit të funksioneve, është diçka që do të mbahet në nivel qendror apo do të jetë diçka që do të decentralizohet në nivel rajonal. Për këtë po bëhet një analizë funksionale e mirëfilltë, që bashkëngjitur do të ketë edhe një analizë funksionale, një vlerësim të nevojave të stafit në Tiranë dhe në rajone për ngritjen e kapaciteteve të mëtijshme për të kryer këto funksione kaq të rëndësishme.

Klodiana Spahiu - Faleminderit!

Adelina Rista - Faleminderit, zonja Ministre për paraqitjen nga ana juaj të këtij projektligji në komision!

Është për t'u falënderuar ardhja juaj sot këtu, pas kërkesës që bëri opozita, sot ajo e ka braktisur komisionin. Duket sesa seriozisht e kishin, prandaj ju falënderoj dyfish!

Në projektligj është parashikuar dhe shtimi i një kreu: ai i programeve pasive për tregun e punës. Desha të di diçka më tepër për shtimin e këtij kreu. Kjo më shumë për ta sqaruar për publikun, për ata që na dëgjojnë.

Dajna Sorensen - Faleminderit!

Është pyetje shumë me vend. Kudo në botë ka dy programe të punësimit: programet pasive dhe programet aktive. Për sa u përket programeve, programet pasive janë pagesa e papunësisë dhe pagesa të tjera që lidhen me ndihmën ekonomike. Programet aktive janë ato që i mundësojnë të gjithë ata që janë të papunë për t'u riintegruar në tregun e punës. Unë do t'ju jap një shifër: në vitin 2013 numri i personave që ishin të përfshirë në programet aktive të nxitjes së punësimit ishte rreth 900. Aktualisht ne po i afrohem shifrës 6 mijë persona që mbulohen vit pas viti me programet e nxitjes së punësimit. Pra, më pak se 1% e punëkërkuësve të papunë ishte mbuluar me programet aktive të tregut të punës, balanca duhet të jetë e ndryshme. Ne duhet të fokusohemi ekskluzivisht për t'i trajtuar punëkërkuësit me programe aktive. Në vitin 2018 rreth 6,5 % e të gjithë të papunëve ishin të mbuluar me programe aktive. Objektivi ynë për vitin 2020 është minimumi 10% të jenë të përfshirë në programe aktive të tregut të punës. Është edhe një nga obligimet që ne kemi në lidhje me mbështetjen buxhetore sektoriale të BE-së, ka qenë një nga target që kemi pasur dhe e kemi arritur, madje tejkaluar.

Almira Xhembulla - Faleminderit, zonja Spahiu!

Falënderoj zonjën Ministre për prezencën dhe për prezantimin shterues të projektligjit “Për nxitjen e punësimit”! Është një nismë që e kemi pritur me shumë kureshtje, por ndërkohë kemi qenë shumë të interesuar, sidomos për disa nga ne që vijmë nga zona, të cilat vazhdojnë ta kenë të lartë numrin e të papunëve. Ju e sqaruat projektligjin shumë mirë në prezantimin që bëtë, por edhe një herë dua të theksoj se ky projektligj do të jetë edhe si një mekanizëm koordinues i të gjitha përpjekjeve që janë bërë deri tani. Ndoshta kanë qenë shërbimet që ofrojnë institucionet publike, strategjitë e ndryshme që janë bërë në kuadër të nxitjes së punësimit, përpjekjet që janë bërë për arsimin profesional, qoftë ato pasive dhe ato jo pasive që sqaroi zëvendësministria, por a mendoni se është parë si një mekanizëm formal, i cili do t'i fusë të gjitha këto përpjekje në një linjë për të shtuar dhe për të rritur eficiencën, impaktin që ne do të kemi për papunësinë? Ndoshta mund të shpreheni pak më gjatë në lidhje me këtë.

Pyetja tjetër, vjet u bë një tur nga një grup deputetësh dhe ekspertësh për sa u përket çështjeve të punësimit. A janë marrë komente nga këto dëgjesa që janë zhvilluar në disa nga qarqet më të rëndësishme të Shqipërisë për sa i përket mënyrës sesi është parë nga grupet e interesit?

Në momentin që do ta diskutojmë nen për nen do të kemi mundësi dhe hapësira që shumë nga komentet që kemi marrë nga grupe të interesit, nga shoqatat, grupet e shoqërisë civile t'i përfshijmë pavarësisht se ashtu siç u shprehën kolegët shumë nga shërbimet sidomos nga grupet vulnerabël apo shtresat në nevojë e gjejnë veten, por këtë do t'ia lëmë fazës tjetër kur do të diskutojmë nen për nen. Shumë nga komentet e tyre, besoj se janë relevante dhe ne do të kemi hapësira dhe mundësi për t'i përfshirë.

Klodiana Spahiu - Po, zonja Ministre!

Anila Denaj – Faleminderit!

Besoj se është bërë punë e mirë dhe shumë të tjera duhet të bëhen, kemi ende shumë punë përpara. Një element shumë i rëndësishëm për të promovuar këtë nismë dhe në nivelin praktik janë edhe këshillat konsultativë trepalësh, qoftë në nivelin qendror, qoftë në atë lokal. Në nenet 15 dhe 16 janë përshkruar, pavarësisht se do të jenë aktet e tjera nënligjore që do të përcaktojnë veprimtarinë e tyre, si institucione që kanë më tepër sesa një grup punonjësish që punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe këshillat konsultative do t'i japin një shtysë më të madhe. Në nivelin e politikëbërjes ne e kemi në fokus dhe duam shumë ta vëmë theksin te ndërlidhja e punësimit me zhvillimin e shkollave profesionale, në mënyrë që këto të dyja të shkojnë në përshtatshmëri të plotë me kërkesat e tregut të punës. Ne jemi duke parë diçka së brendshmi në raport me projeksionet 3- 5 vjeçare. Tregu i punës evoluon dhe ajo që kërkohet sot mund të jetë e ndryshme pas 3 vjetësh, por zhvillimi profesional kërkon të dijë sot se ku do të adresohen nevojat për tregun e punës pas 3 vjetësh që ne të kemi nismat tona të brendshme. Këtë jemi duke koordinuar në nivel qendror dhe do ta komunikojmë edhe në platformat e tjera.

Dajna Sorensen – Është një temë që zonja Xhembulla e ka ngritur edhe në mbledhjet e mëparshme, se çfarë qasje kemi ne për adresimin e punësimit në nivel rajonal. Kjo është diçka që ne e kemi ndjekur dhe në mënyrë specifike jemi duke u munduar të kemi programe dhe masa specifike për secilin prej rajoneve. Sfidat e tregut të punës janë ndryshe në Dibër, janë ndryshe në Fier, janë ndryshe në Elbasan. Ne kemi informacion në këtë moment se ku çalojmë në secilin prej rajoneve. Ku e kemi problematikën më të madhe sot me të rinjtë, ku e kemi me grupmoshën 50, plus, ku i kemi, ndër të papunët, nevojat për upskilling, për rritjen e nivelit të aftësive për secilin prej rajoneve. Unë mendoj se ligji në vetvete është një kuadër shumë i mirë, që ne të fillojmë punën. Por gjëja nuk mbaron këtu.

Shumica e problematikave, që unë kam vënë re edhe në zbatim, kanë të bëjnë më tepër me mënyrat... Edhe programet ekzistuese zbatohen në nivel rajonal. Mënyra si ne vendosim e

sa persona apo çfarë prioriteti do t'u japim bizneseve që janë në Dibër, krahasuar me bizneset që janë në Elbasan, ku mund të ketë një treg më fluid punësimi nga sa mund ta ketë Dibra.

Kësisoj, realisht, sfida jonë është që këto politika, që ne i kemi të vendosura në këtë ligj, dhe i kemi të parashikuara, të ngrenë nga ana operationale strukturat, që të mund t'u përgjigjen pikërisht këtyre nevojave.

Për sa i përket pjesës së feedbackut që ne kemi marrë, jemi munduar në maksimumin e mundshëm që ta integrojmë në të gjithë elementët.

Do të thosha edhe një gjë tjetër: qeveria ka një qasje, që vetë kombinimi i të tria portofolave: Financë, Ekonomi, Punësim e nxjerr në pah. Nuk është Shërbimi Kombëtar i Punësimit ai që gjeneron punësim. Janë bizneset ata që gjenerojnë punësim. Dhe qasja është: çfarë mjedisi mundësues po i krijojmë ne bizneseve sot, që ata të gjenerojnë në vijim punësim, e jo vetëm punësim masiv, por mbi të gjitha punësim cilësor, punësim që shkon përtej aksit Tiranë-Durrës, punësim që paguan më mirë e që krijon kushte më të mira pune.

Klodiana Spahiu – Faleminderit!

Meqenëse është edhe mbledhja e qeverisë, do t'ju kërkoja, të nderuar kolegë, një përmbledhje pyetjesh edhe për dhjetë minuta, nëse mundeni. Apo duhet të largoheni tani?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju faleminderit!

Unë kam një kërkesë, meqë nuk arrita të bëj pyetje, por do t'i vazhdoj me zonjën Sorensen. Në komision na kanë ardhur një sërë kërkesash nga grupet e interesit, të cilat jemi përpjekur t'i shohim. Gjithsesi, në bashkëpunim me ju, ne do të vendosim se cilat do të jenë ndryshimet e arsyeshme, të cilat do t'i reflektojmë kur ta miratojmë ligjin nen për nen. Do t'ju lutesha që të kemi një bashkëpunim në vazhdim, që të mund t'i pasqyrojmë sa më mirë edhe kërkesat e grupeve të interesit.

Po ju njoftojmë se ditën e hënë do të kemi seancën dëgjimore me të gjitha grupet e interesit, që janë të interesuar dhe i kanë sjellë tashmë propozimet e tyre. ndoshta një përfaqësues i ministrisë do të ishte i domosdoshëm, për të marrë shënimet, që më pas të konkludojmë edhe me vendimmarrje.

Ju faleminderit për prezencën!

Atëherë, ne mund të vazhdojmë mbledhjen.

Fjalën e kishte zonja Bode. Më pas zoti Xhelilaj.

Edlira Bode – Faleminderit!

Zonja Zëvendësministre, unë po e vazhdoj pikërisht aty ku ju sapo e latë, te kompanitë që gjenerojnë punësim.

Në fakt, nga puna në terren dhe nga përvoja, unë di se kohët e fundit ka ndodhur që kompani të huaja, të cilat gjenerojnë punësim në Shqipëri, shpeshherë kanë nevojë për forcë pune të kualifikuar, madje të kualifikuar në një mënyrë të tillë kualifikimi, që ne këtu nuk e ofrojmë dot, qoftë nëpërmjet arsimit profesional, me gjithë hapat gjigantë që kemi bërë, qoftë nëpërmjet drejtorive të formimit profesional.

A keni menduar se si mund të zgjidhet ky ngërç, dhe si do ta realizojmë kualifikimin e punonjësve shqiptarë, sipas atyre specifikave që kërkojnë kompanitë në Shqipëri?

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Një moment, le ta bëjë pyetjen edhe zoti Xhelili, që t’i mbledhim pyetjet.

Roland Xhelilaj – Faleminderit!

Unë kam një pyetje, e cila realisht na ka shqetësuar vazhdimisht, që lidhet me një problem shumë të rëndësishëm, siç është problemi i punësimit. Është informim i punëkërkuësve dhe i punëdhënësve. Neni 8 e pasqyron saktë. Pyetja është: a e arrin dot struktura rajonale vendore e punësimit, që të bëjë gjithë këtë informim, që këtu është parashikuar shumë drejtë me pika: a, b, c, ç, d.

Dukke pasur parasysh situatat e trashëguara, me gjithë përmirësimet e ndjeshme që janë bërë gjatë kësaj periudhe, ngarkesa më duket shumë e madhe, ndaj nuk e di si do të realizohet, është menduar? Do të ketë akte nënligjore, do të ketë bashkëpunim me sektorë të tjerë apo jo? Më intereson kjo.

Klodiana Spahiu – Zonja Sorensen, mund të përgjigjeni.

Dajna Sorensen – Do t’u jap përgjigje shumë të shpejtë të dyja pyetjeve. Për sa i përket bashkëpunimit me sektorin privat dhe përgjigjes ndaj nevojave ekzistuese në tregun e punës, por edhe nevojave që ende s’jemi në gjendje t’i parashikojmë, qoftë ato të investitorëve të huaj, qoftë ato të investitorëve vendës. Absolutisht që ne kemi një hendek të aftësive në Shqipëri, dhe thembra e Akilit është fakti se sa shpejt jemi ne në gjendje t’u përgjigjemi nevojave të ndryshueshme për aftësi.

Unë mendoj se me strukturën aktuale dhe me dhjetë qendrat e formimit profesional, në nuk jemi në gjendje t’u përgjigjemi mjaftueshëm shpejt nevojave të tregut të punës. Në qoftë se shikojmë numrin e personave që përfitojnë nga kurset afatshkurtra, ai është shumë i vogël krahasuar me nevojat që janë në tregun e punës. Prandaj, është domosdoshmëri të ecim përpara me reformën e qendrave multifunksionale. Sot i kemi shkollat të pajisura njëlloj si në vendet më të mira në botë. Ato kanë mundësi që, përveç programeve afatgjata, të ofrojnë edhe

programe afatshkurtra. Synimi ynë është që brenda shtatorit të këtij viti, të paktën pesë qendra të reja multifunksionale në treg, për të ofruar kurse afatshkurtra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Trajnuesit duhet të vijnë nga sektori privat. Pra, ne jemi të detyruar të bashkëpunojmë me sektorin privat. Janë ata që njohin teknologjinë, janë ata që njohin nevojat teknike. Ky projektligj parashikon pikërisht këtë gjë, modalitete bashkëpunimi me sektorin privat. Madje, në disa raste, kur ne nuk jemi në gjendje të ofrojmë nëpërmjet qendrave publike disa kualifikime, që janë shumë specifike, mund të jemi të detyruar që ta kalojmë këtë funksion edhe te një ofrues privat, i cili mund t'u përgjigjet nevojave të tregut shumë më shpejt e në mënyrë të drejtpërdrejt.

Për sa i përket pjesës së informimit dhe funksionit të informacionit të tregut të punës për punëkërkuar dhe punëdhënësit, kjo është një problematikë me shumë vend. Nëse marrim zyrat rajonale dhe ngarkesën që ka çdo specialist i punësimit në lidhje me numrin e të papunëve në secilin rajon, do të shohim se specialistët tanë të punësimit kanë një fluks të papunësh, që është dyfishi e deri katërfishi i standardit të vendeve të BE-së.

Në nivel qendror, ne po mundohemi të sistemojmë informacionin e tregut të punës dhe ta bëjmë të aksesueshëm në nivel rajonal. Analizën po e bëjmë në nivel qendror, me idenë që t'i ngremë kapacitetet më vonë, që të paktën ta transmetojmë këtë informacion të tregut të punës në nivel lokal. Ka një sërë studimesh që lidhen me nevojat e sektorit privat, edhe të rajonalizuara. Është shumë e nevojshme që ky material të përkthehet në një gjuhë që i flet edhe punëkërkuar, edhe biznesit, por mbi të gjitha edhe atij specialistit të zyrës së punës, për t'u transmetuar më tej te të papunët. Është një sfidë. Megjithatë, do të thosha se ne kemi edhe shumë mbështetje, si nga partnerët tanë ndërkombëtarë, ashtu edhe nga Bashkimi Europian, që ka mbështetje sektoriale buxhetore pikërisht për këtë sektor.

Klodiana Spahiu – Faleminderit!

Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, kam unë nja dy a tri pyetje të vogla.

Në këtë komision është diskutuar shumë gjatë në lidhje me arsimin dhe formimin profesional. Ne e dimë se kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë me ndërkombëtarët, pra kanë qenë investime të vazhdueshme.

Në fillim të fjalës suaj, thatë se ky projektligj ka si qëllim edhe bashkëpunimin dhe koordinimin e zyrave të punës me arsimin dhe formimin profesional. Për të qenë më praktikë, a mund të na shpjegoni një rast, ose, a kemi statistika të caktuara, që nga ky arsimi dhe formimi profesional, në lidhje me numrin e atyre që janë përgatitur deri më tash? Si ka qenë bashkëpunimi me zyrat e punës? E para.

E dyta, kam një pyetje për Këshillin Konsultativ Tripalësh, që do të jetë edhe qendror, edhe rajonal. Nga eksperiencia e deritanishme dhe nga puna që është bërë në dy sektorë, shëndetësi dhe arsim, ne kemi një praktikë të re, ku në sektorin e shëndetësisë tashmë është bërë një ndarje e re në katër rajone. Mendoni se në sektorin e ri të Këshillit Konsultativ Tripalësh do të ketë një qasje të tillë që ka edhe në këta sektorë? Domethënë, gjithmonë duke qenë në përshtatje me kërkesat që ka rajoni që përfaqëson. E kuptoj që secili rajon ka kërkesat e veta të tregut të punës dhe duhet të përshtatet me kërkesat e punës që kërkon rajoni në vetvete, por nuk mendoni se është e ekzagjeruar të krijohet kaq shumë numër i lartë këshillash konsultativë?

Këto janë dy pyetjet që kisha.

Dajna Sorensen – Po e nis nga pyetja e dytë me një përgjigje shumë të shpejtë për sa u përket këshillave konsultativë.

Këshillat konsultativë kanë funksionin e parë të tyre orientimin e programeve të nxitjes së punësimit dhe vlerësimin e dobishmërisë së tyre social-ekonomike në secilin prej rajoneve, për t'i orientuar, së pari, se cilat janë programet që duhen zbatuar. Unë e shikoj vlerën e këtyre këshillave konsultativë, të cilët kanë qenë funksionalë edhe më parë. Domethënë, këta këshilla kanë ekzistuar edhe në projektligjin e vjetër dhe kanë qenë funksionalë.

Për sa i përket arsimit dhe formimit profesional, unë do të thosha se roli i këshillave është shumë më larg. Ne po shikojmë për Këshillin Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional, që është i rregulluar me ligjin e arsimit dhe formimit profesional. Për atë bën shumë më tepër sens që të jetë ndoshta në nivelin e katër rajoneve, ndërsa për këshillat konsultativë tripalësh realisht ne kemi nevojë që tregu i punës të flasë shumë më tepër me institucionet në nivel rajonal dhe të kuptohet fakti që të gjitha këto institucione, që janë të përfshira në këshillin konsultativ, kanë një zë, kanë një fjalë për sa i përket orientimit të këtyre programeve.

Klodiana Spahiu – Po për pyetjen e dytë, që ishte në lidhje me bashkëpunimin që keni ju me arsimin dhe bashkëpunimin profesional me pesë qendrat multifunktionale?

Pas miratimit të ligjit që ne kemi bërë dhe janë krijuar qendrat multifunktionale, aktualisht janë 5 në të gjithë Shqipërinë?

Dajna Sorensen – Pesë qendra do të jenë funksionale në shtator.

Klodiana Spahiu – Aktualisht kemi qendra funksionale?

Dajna Sorensen – Kemi qendra multifunktionale të krijuara.

Klodiana Spahiu – Atëherë, cili është bashkëpunimi i qendrave aktuale multifunktionale me zyrat e punës?

Dajna Sorensen – Aktualisht këto dy institucione janë të pavarura nga njëra-tjetra. Ky projektligj i sjell të dyja në një ombrellë të përbashkët bashkëpunimi. Për shembull, aktualisht Shërbimi Kombëtar i Punësimit është duke ofruar një paketë për *soft skills* për të gjithë punëkërkuarit e tyre të papunë. Brenda 10 qendrave që ka në menaxhimin e vet Shërbimi Kombëtar i Punësimit, qendra trajnimit afatshkurtër nuk ka shanse që të arrijë t'i mbulojë të gjithë ata që janë të papunë me këto kurse afatshkurtra. Në momentin që Këshilli Kombëtar i Punësimit apo agjencia e re që do të krijohet në vijim do të ketë në varësi të saj edhe shkollat ose qendrat multifunksionale të arsimit dhe formimit profesional, ata do të jenë në gjendje të kenë një ofertë më të gjerë dhe t'i ofrojnë edhe këto kurse në të gjitha shkollat multifunksionale. Shërbimi Kombëtar i Punësimit është shumë më afër me nevojat e tregut të punës, që shkollat nuk janë gjithmonë dhe për këtë është domosdoshmëri, që brenda të njëjtit institucion ti ke edhe informacionin e tregut të punës dhe u përgjigjesh nevojave që ti i prek në terren nëpërmjet institucioneve që i ke në varësi, që janë institucionet e ofertës së arsimit dhe formimit profesional. Prandaj është kaq e domosdoshme që këto të dyja të jenë bashkë.

Klodiana Spahiu – Faleminderit!

Cili shtet e ka këtë model?

Dajna Sorensen – Në shumë vende ka institucione të arsimit dhe formimit profesional. Edhe Zvicra ka konkretisht. Nuk e di si menaxhohen në nivel rajonal institucionet në vetvete, por edhe në shtetet e tjera arsimit profesional dhe punësimi janë funksione që janë bashkë me njëra-tjetrën. Zvicra është një nga vendet që unë di, që e ka një gjë të tillë.

Nuk e di nëse e kanë me Shërbimin Kombëtar të Punësimit, por në nivel qendror i kanë të bashkuara si funksione.

Klodiana Spahiu– Faleminderit, zonja Sorensen!

Me sa kuptova, edhe ju jeni pro krijimit të këshillave vendorë tripalësh në jo më shumë se 4 rajone, apo jo?

Dajna Sorensen – Për pjesën e arsimit profesional, po.

Për sa i përket punësimit, në kuadër të kësaj analize funksionale, që ne jemi duke ndërmarrë për funksionet e reja të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, po i mbajmë shënim dhe është një pikë që mund ta vlerësojmë sërish, nëse do të jetë e nevojshme ose jo, që të jenë 4 ose 12, siç janë aktualisht.

Klodiana Spahiu – Kolegë, keni pyetje, diskutime apo sqarime për projektligjin?

Atëherë, kur të bëjmë diskutimin nën për nën kemi edhe disa shtesa, sugjerime tona, që mendojmë se te grupet e interesit duhen shtuar.

Edhe një herë do t'ju lutesha të kemi një bashkëpunim në ditët në vijim para se ky projektligj të kalojë nen për nen, sepse vërtet është shumë i rëndësishëm dhe është prej shumë vjetësh i domosdoshëm për tregun e punës. Përderisa diskutohet për punësimin, kuptohet sa i rëndësishëm është për të gjithë qytetarët shqiptarë.

Faleminderit për prezencën tuaj!

E mbyllim mbledhjen e komisionit dhe ju bëj me dije se ditën e hënë ne kemi diskutimin me grupet e interesit, seancën dëgjimore, dhe nëse do të mbarojmë pas asaj mbledhjeje, ditën e martë, për kolegët, kemi diskutimin nen për nen të këtij projektligji.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA